



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL ¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 15.01.2020, ora 12.00

Drejton mbledhjen

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës :

1. Kostituimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, me përbërjen e zgjedhur për të ushtruar funksionet dhe përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore për vitin kalendarik 2020.

2. Çështje të mbështetjes së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me mjete buxhetore, personel administrativ, ambiente dhe pajisje pune nga Gjykata e Lartë për vitin 2020.

3. Informacion për vendet vakante ekzistuese për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të cilat sipas Kushtetutës plotësohen nga Presidenti i Republikës, Kuvendi dhe Gjykata e Lartë.

4. Procedura e shortit për caktimin e anëtarëve relatorë për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për vendet vakante si më poshtë:

- 1. Vendi vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Fatos Lulo.*
- 2. Vendi vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019 nga Presidenti i Republikës, për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj.*
- 3. Vendi vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 22.11.2019 nga Presidenti i Republikës për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Muçi.*

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni 232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

Marrin pjesë :

- | | |
|------------------------|------------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetare) |
| 3. Fiona Papajorgji | (anëtare) |
| 4. Miranda Andoni | (anëtare) |
| 5. Saida Dollani | (anëtare) |
| 6. Fatjona Memçaj | (anëtare) |
| 7. Ludovik Dodaj | (anëtar) |
| 8. Arjan Qafa | (anëtar) |
| 9. Marsida Xhaferllari | (anëtare zëvendësues) |
| 10. Bilbil Mete | (anëtar zëvendësues) |
| 11. Nazmi Troka | (anëtare zëvendësuese) |
| 12. Nezir Gjoka | (anëtare zëvendësuese) |

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.
2. Korab Lita, zv/kryetar i Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si përfaqësues i opozitës në Kuvend.

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Konstatohet mungesa e anëtares Arta Marku.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, informon se zonja Arta Marku e ka njoftuar motivin e mosparaqitjes në mbledhje dhe që ka të bëjë me çështjen e parë të rendit të ditës, me konstituimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të zgjedhur me short për të ushtruar veprimtarinë për vitin 2020, motive që do të referohen në punimet për këtë pikë të rendit të ditës. Gjithashtu, megjithë konfirmimin për pjesëmarrje, sipas komunikimit të fundit pak çaste përpara fillimit të mbledhjes, nuk mund të jenë i pranishëm z. Ulsi Manja, Kryetari i

Komisionit të Ligjeve dhe përfaqësues i shumicës në Kuvend, për shkak të një problemi shëndetësor të papritur.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, sugjeron vijimin e mbledhjes me pikën e parë të rendit të ditës mbi kostituimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, me përbërjen e zgjedhur për të ushtruar funksionet kushtetuese dhe ligjore për vitin kalendarik 2020.

Informon mbledhjen e Këshillit mbi motivet e mosparaqitjes së anëtares Arta Marku, të cilat janë paraqitur me shkrim po në ditën e mbledhjes dhe i janë vendosur në tavolinë secilit pjesëmarrës në mbledhje. Znj. Marku, në thelb, konfirmon marrjen e njoftimit për datën, orën mbledhjes dhe rendin e ditës, thekson se pjesëmarrja në mbledhje është detyrim ligjor. Nga ana tjetër parashtrohet se është e detyruar të mos marrë pjesë në këtë mbledhje për shkak se në 5 Dhjetor 2019 është realizuar shorti dhe është përzgjedhur si pjesë e Këshillit si përfaqësuese e Prokurorisë së Përgjithshme dhe, po në këtë date, më vonë, Kuvendi i Shqipërisë ka zgjedhur Prokurorin e ri të Përgjithshëm, moment pas të cilit nuk ishte më Prokurore e Përgjithshme. Znj. Marku shprehet se ndjen detyrim moral që ti kërkojë Këshillit të mbajë një qëndrim në lidhje me këtë fakt, pra nëse duhet të vazhdojë funksionin si anëtare e KED apo duhet organizuar ndonjë short tjetër nga Presidenti i Republikës ose duhet që në vendin e saj pa qenë nevoja e një shorti, të kalojë anëtari zëvendësues. Thekson faktin se nuk e konsideron si shmangie nga detyrimet ligjore mosparaqitjen në këtë mbledhje por e ka vlerësuar si një moment që ajo përpara se të ushtrojë detyrën të ketë edhe një qëndrim nga ana e këtij Këshilli.

Informohet secili pjesëmarrës në mbledhje se i është vendosur në tavolinë edhe një Raport i dërguar nga Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i cili përmban qëndrimin dhe rekomandimet e këtij Komisioni në lidhje me kostituimin e KED që do të funksionojë për vitin 2020. Ky material ka mbërritur pranë KED ditën e sotme, përpara fillimit të mbledhjes.

Informohet Këshilli se përbërja e tij është zgjedhur me short nga Presidenti i Republikës në datën 05.12.2019. Kjo procedurë zgjedhjeje është bërë publike, është përcjellë drejtpërdrejt në media, si edhe i është përcjellë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me shprehjen e Institucionit të Presidentit të Republikës me nr.4647/1 prot, datë 06.12.2019. Sipas rezultatit të shortit, ky Këshill ka në përbërjen e tij 9 anëtarë dhe 4 anëtarë zëvendësues. Sipas përcaktimeve të ligjit Këshilli duhet të ketë 6 anëtarë zëvendësues, por njëra nga anëtare zëvendësuese e zgjedhur me short nga Presidenti i Republikës, znj. Marjana Velcani, me vendim të KPK të datës 12.12.2019 është shkarkuar nga detyra dhe prandaj për shkak të

ligjit është e pezulluar nga ushtrimi i funksioneve gjyqësore, përfshirë këtu edhe ushtrimin e detyrës si anëtare zëvendësuese në KED. Gjithashtu nuk ka anëtare zëvendësues nga radhët e gjyqtareve të Gjykatës së Lartë, për shkak të mungesës së kandidaturave përkatëse për tu shortuar nga Presidenti i Republikës.

Anëtarët dhe anëtarët zëvendësues të Këshillit diskutojnë në lidhje me pikën e parë të rendit të ditës. Në përfundim të diskutimeve dhe shprehin qëndrimin e tyre.

Ardian Dvorani shpreh qëndrimin se përbërja e KED është e vendosur në momentin e realizimit të shortit nga Presidenti i Republikës apo Kuvendi dhe sipas kushteve të zgjedhshmërisë në atë moment, nuk ndikohet nga lëvizjet në detyrë të anëtarit pas zgjedhjes për sa kohë është në sistem dhe KED nuk ka kompetencë të vendosë për mandatin e një anëtari.

Saida Dollani shpreh qëndrimin se si anëtare e Këshillit ligji nuk i ka dhënë autoritet të verifikojë mandatin e një anëtari tjetër të KED dhe as për të vendosur mbi çfarë ka parashtruar znj. Arta Marku. Sipas ligjit, zgjedhjen e anëtarëve e ka realizuar Presidenti i Republikës me anë të shortit dhe, sipas nenit 288 të ligjit nr.115/2015, Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimin e Ligjit nr.115/2016, ka dhënë opinionin e tij.

Ludovik Dodaj shpreh qëndrimin se nuk është e përcaktuar në ligj dhe aktet nënligjore të KED që Këshilli të shprehet për mandatin e një anëtari. Zgjedhja e këtij KED për vitin 2020 është e kryer siç është përcaktuar në Kushtetutë e ligj dhe znj. Arta Marku duhet të ishte e pranishme në mbledhje.

Arjan Qafa shpreh qëndrimin se nuk është në kompetencën e këtij KED për tu shprehur për shkresën e znj. Arta Marku dhe secili nga anëtarët duhet të qëndrojë në këtë detyrë sipas kuadrit ligjor.

Anëtarët Vitore Tusha, Fiona Papajorgji dhe Miranda Andoni shprehën nevojën që, përpara se të japin qëndrimin e tyre, të ketë një pushim të shkurtër për tu konsultuar me shkresën e znj. Arta Marku dhe me Raportin e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimin e Ligjit nr.115/2016, me të cilat janë njohur vetëm përpara fillimit të mbledhjes.

Marsida Xhaferllari shpreh mendimin se hapi i parë i këtij Këshilli të jetë konstituimi i secilit nga anëtarët dhe pastaj të kalohet në procesin e diskutimit dhe vendimmarrjes së çështjes. Një çështje procedurale është dërgimi po në ditën e sotme i Raportit të Komisionit të Pavarur, si edhe i shkresës nga znj. Marku në rrugë elektronike me email adresë private, ndërkohë që njoftimi i mbledhjes së Këshillit, ku përfshihen edhe këto

materiale, duhet të bëhej të paktën 5 ditë përpara asaj të mbledhjes. Paraprakisht shpreh qëndrimin se KED nuk ka kompetencë të vlerësojë mandatin e një anëtari të tij.

Bilbil Mete shpreh mendimin se nuk ka shkaqe ligjore për të zëvendësuar anëtaren Arta Marku në përbërje të KED 2020. Në kohën e hedhjes së shortit nga Presidenti i Republikës ishte përfaqësuese e Prokurorisë së Përgjithshme dhe aktualisht është brenda sistemit të prokurorisë.

Nazmi Troka shpreh mendimin se nuk është në kompetencën e KED të japë mendimin nëse duhet të pranohet që të jetë apo të mos jetë anëtare e KED për vitin 2020, znj. Arta Marku.

Nezir Gjoka shpreh mendimin se nuk është objekt shqyrtimi i këtij Këshilli ajo që parashtron në shkresën e saj znj. Arta Marku.

Këshilli ndërpret diskutimet për një pushim të shkurtër, në mënyrë që, sipas kërkesës së paraqitur, disa nga anëtarët e Këshillit të njihen më shumë me përmbajtjen e dy materialeve të paraqitura përpara fillimit të mbledhjes.

PJESA E DYTË E MBLEDHJES

Mbledhja e Këshillit, pas pushimit, vijon me pikën e parë të rendit të ditës, me parashtrimin e mendimeve dhe qëndrimit të anëtarëve të tjerë të Këshillit.

Vitore Tusha, pas diskutimit, shpreh qëndrimin se kostituimi i KED bëhet në mbledhjen e parë të tij. Më përbërjen e Këshillit për vitin kalendarik 2020 jemi të njohur nga momenti i organizimit të shortit nga Presidenti i Republikës në datën 05 dhjetor 2019. Prandaj znj. Arta Marku është njoftuar rregullisht për të qenë e pranishme në mbledhje dhe duhet të ishte pranishme. KED nuk e ka të parashikuar të shprehet për mbarim mandati të anëtarit të Këshillit. Gjithashtu mbarimi i mandatit të anëtarit në KED lidhet me mbarimin e mandatit të tij si magjistrat. Znj. Marku është magjistrate dhe nuk është në kushte papajtueshmërie për ushtrimin e detyrës si anëtare e KED, situatë që do të sillte problematika për veprimtarinë e Këshillit.

Fiona Papajorgji, pas diskutimit, shpreh qëndrimin se KED nuk e ka të parashikuar në ligj dhe akte nënligjore kompetencën të shprehet dhe të mbajë qëndrim për mbarimin ose jo të mandatit të anëtarit në një situatë të tillë si ajo që parashtron me shkresë znj. Arta Marku. Gjithsesi, Kushtetuta dhe ligji e ka të përcaktuar se kriteret në përzgjedhjen e anëtarëve të KED-së lidhen me momentin e organizimit të shortit. Nuk ka asnjë parashikim kushtetues apo ligjor që të përcaktojë procedurë përsëritje të shortit dhe nga ana tjetër nuk

parashikohet përfundimi i mandatit si anëtar i KED për shkak të ndryshimit të funksionit të anëtarit.

Miranda Andoni, pas diskutimit, shpreh qëndrimin se sipas nenit 229 të ligjit nr.115/2016 znj. Arta Marku duhet të ishte pjesë e kësaj mbledhje. Gjithashtu, edhe në lidhje me shkresën e saj, në asnjë dispozitë ligjore nuk përcaktohet që KED të diskutojë dhe të disponojë lidhur me vazhdimësinë ose jo të mandatit të një anëtarit të tij në një situatë të tillë.

Fatjona Memçaj, pas diskutimit, shpreh qëndrimin se këto çështje janë diskutuar në parim edhe në fillim të veprimtarisë së KED 2019, ku qëndrimi ishte se nuk e kemi kompetencën që në Rregulloren tonë të Brendshme të përfshijmë një parashikim të tillë. Duke mirëkuptuar shkresën e paraqitur nga znj. Marku, sepse secili mund të ndodhet në një situatë të tillë, KED si organ kolegjal, sipas ligjit, nuk ka për këtë rast kompetencë vendimmarrje. Qëndrimet e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimin e Ligjit nr.115/2016 ngelen në kuadrin e një rekomandimi. Gjithsesi janë në thelb të njëjtat argumente që i kam dhënë një vit më përpara. Kriteret që përcakton ligji për të qenë anëtar i KED në nenin 221 të tij vlejné dhe lidhen me momentin e organizimit të shortit. Kriteri themelor mbetet ai i qenies magjistrat. Humbja e një cilësie të tillë është ajo që e bën anëtarin të mos jetë më pjesë e KED.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pas diskutimit dhe dhënies së qëndrimeve nga të gjithë anëtarët e KED, sipas Rregullores orienton anëtarët dhe anëtarët zëvendësues nëse vlerësojnë të diskutojnë përsëri për këtë çështje.

Marsida Xhaferllari, merr fjalën dhe shpreh qëndrimin se rastin e znj. Arta Marku e ka marrë në shqyrtim KLP i cili në caktimin në mënyrë të përkohshme në detyrën e prokurores pranë Gjykatës së Apelit Tiranë është shprehur që vendimi të hyjë në fuqi në datën 31.12.2019, me qëllim që asaj të mos i pengohet pjesëmarrja në KED. Funkzioni i Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimin e Ligjit nr.115/2016 është të monitorojë, të ndjekë ecurinë e zbatimit të ligjit, të bëjë koordinimin e Institucioneve që zbatojné ligjin për ngritjen e organeve të reja dhe të raportojë në Komisionin e Ligjeve, por që nuk mund të bëjë rekomandime. Raporti me rekomandimet është i nënshkruar nga zoti Artan Spahiu, i cili është një nga kandidatët që pritet të verifikohet dhe të pikëzohet nga KED-ja për pozicionin e anëtarit në Gjykatën Kushtetuese që ka një rrezik potencial për konflikt interesi. Për sa i takon mandatit të anëtares kompetenca nuk i takon Këshillit të shprehet, por vetë znj. Marku të bëjë një vlerësim shumë të kujdesshëm të fakteve dhe të shprehë qëndrimin e saj.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pas diskutimit dhe dhënies së qëndrimeve nga anëtarët e KED, fton pjesëmarrësit e tjerë në mbledhje për të vlerësuar dhënien e mendimeve të tyre.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe shprehet se në përputhje me nenin 7 të Rregullores, edhe në kohë edhe nëse ju merrni kohë, gjithsesi ne na jepet fjala përpara se të vazhdoj vendimarrja. Pavarësisht kësaj, tërheq vëmendjen e Këshillit në dy elementë të rëndësishëm të cilësive të anëtarëve të KED.

Është hera e parë që kemi Këshillin e Emërimeve në Drejtësi dhe jo Këshillin e Përkohshëm të Emërimeve në Drejtësi. Ka një diferencë për mënyrën se si propozohen kandidatët apo se cilat janë organet që dërgojnë emërtesat e kandidatëve. Edhe për këtë ka pasur një debat shumë të madh juridik dhe ka qenë pikërisht ky Komision i cili ka vendosur në një mënyrë, për mendimin tim totalisht të pabazuar në ligj, se çfarë lloj natyre ka pasur Këshilli i mëparshëm, i përkohshëm apo i përhershëm. Në këtë rast, fakti nëse do të përfshihej në short apo jo zonja Marku, nuk është vendosur prej saj, por nga KLP. Nëse herën e parë, në përcjelljen e listave për short në Dhjetor të vitit 2018, ka qenë ajo që e ka dërguar listën duke qenë se nuk ishte krijuar ende KLP, për këtë rast ajo nuk ka pasur zë në përfshirjen apo jo të personit të saj në listat e dërguara. Pra edhe diskutimi nëse zonja ka qenë apo jo pjesë e Prokurorisë së Përgjithshme apo ka qenë e përkohshme, e komanduar, nuk ka qenë një vendimarrje të cilën e ka trajtuar ajo, por ka qenë një vendimarrje e KLP. Nëse ajo do të kishte një kundërshtim me këtë çështje ajo mund të kishte bërë ankim. Por ajo nuk ka bërë ankim në lidhje me këtë fakt, e ka pranuar faktin që në momentin kur është hedhur shorti i ka plotësuar kriteret për të qenë edhe në këtë detyrë.

Është e qartë që KED nuk ka kompetencë, të paktën siç parashikohet nga ligji, për të përcaktuar apo për të vërtetuar nëse secili prej anëtarëve ka apo jo mandat për ta ushtruar këtë detyrë. Kjo është diskutuar edhe në mbledhjen në vitin e kaluar kur ka qenë më problematike çështja sepse atëherë nuk ishim ndryshuar kriteret shumë strikte që përcaktonte ligji për përzgjedhjen e anëtarëve të KED. Një pjesë e anëtarëve, pavarësisht se e kishin marrë mandatin nga Kuvendi për shkak të shortit, nuk i plotësonin kriteret ligjore që ligji i përcaktonte në atë moment. Pra ata persona edhe në momentin e hedhjes së shortit nuk i plotësonin kriteret e përcaktuara dhe qëndrimi i Këshillit në atë rast ka qenë që ne nuk i hymë kësaj çështjeje pasi nuk vendosim vetë nëse do të jemi apo nuk do të jemi anëtar të KED. Përtej gjithë këtyre diskutimeve, unë mendoj se është shumë e nevojshme që Këshilli të ketë numrin e mjaftueshëm të anëtarëve, që të ketë diversitet, diskutime dhe të trajtohen

problematikat nga sa më shumë anëtarë. Çdo lloj interpretimi ligjor i cili çon në një ulje të numrit të anëtarëve nuk do të sillte përmirësimin e performancës të këtij Këshilli.

Ka pasur probleme në lidhje me legjitimitimin e anëtarëve edhe në Këshillin e parë që nuk është mbledhur për shkak se që në momentin e parë kryetari nuk ekzistonte më, pra u zgjodh kryetar por nuk ishte më gjyqtar, sepse i kishte mbaruar mandati. Kryetari i KED kishte një zëvendësues që u bë zëvendësues i përhershëm që duhet të ishte edhe kryetar, i cili mbajti qëndrimin se unë nuk e ushtroj këtë detyrë sepse nuk jam zgjedhur në mënyrë të përhershme por si zëvendësues i përkohshëm. Tani në mënyrë rastësore duket që duhet të kemi prapë një qëndrim a do të kemi apo jo anëtar përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme.

Këshilli i dytë, u mbledh, ra numri dhe znj. Vitore Tusha nuk e konsideroj veten, duke qenë se ishte anëtare zëvendësuese, që ta vazhdonte sepse ishte anëtare zëvendësuese, nuk ishte anëtare e përhershme dhe nuk mund ta ushtronte në mënyrë të vazhdueshme detyrën në kuptimin e ...

Vitore Tusha ndërhyr dhe saktëson faktin se nuk mund të ishte zëvendëskryetare e KED.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe vijon falën duke u shprehur se e kuptoj, por dua të shpjegoj se kemi pasur gjithmonë diskutime dhe Këshilli ka dalë në përfundimin se është vetë individi që e përcakton, sepse ne jemi të gjithë gjyqtarë, magjistratë, njerëz të cilët kanë njohuri të thellë të ligjit, që e vlerësojnë nëse i plotësojnë apo jo kushtet e ligjit deri në atë moment që vepron një organ tjetër i përcaktuar nga ligji që ne këtu nuk e kemi. Organet përkatëse mund ti kishin përjashtuar nga listat. Kështu që edhe në këtë rast vlerësimi duhet të bëhet, në gjykimin tim, drejtpërsëdrejti nga ana e zonjës Marku. Përsëri qëndrimi i Avokatit të Popullit është që të ketë sa më shumë anëtarë në numër, duhet të jenë 9, sepse është shumë e rëndësishme fryma e ligjit dhe që të ketë një diversitet të mjaftueshëm në mënyrë që përfundimet apo vendimet e marra nga ky Këshill të përfaqësojnë e të vijnë si rezultat i një numri të madh anëtarësh dhe jo një numri minimal që është ai 5 sepse kjo e rrezikon në gjykimin tim edhe cilësinë e vendimmarrjeve të Këshillit.

Përsa i përket këtij dokumenti të Komisionit të Pavarur dhe faktit që i është dërguar Këshillit, gjykoj që ky Komision nuk ka as edhe një kompetencë, së pari, për ta marrë këtë lloj vendimmarrje dhe për t'ia dërguar Këshillit. Kam gjykuar se nuk ka pasur kompetencë as herën e parë, ndër të tjera, për të vendosur nëse ishte apo jo Këshilli i Emërimeve, i Përkohshëm apo i Përhershëm. Kam pasur të njëjtin qëndrim atëherë dhe kam po të njëjtin qëndrim edhe tani. Për mua kjo vendimmarrje, e cila bën interpretim të ligjit, më duket

tërësisht jo në përputhje me ligjin. Madje edhe Këshilli duhet të mbajë një qëndrim për këtë. Nëse ne e marrim dhe nuk kemi asnjë qëndrim atëherë i bie që nesër të pranojmë edhe interpretime të tjera të ligjit që i bën ky Komisioni sikur të jetë një vendim unifikues i Gjykatës së Lartë apo një vendim i Gjykatës Kushtetuese për interpretimin përfundimtar të ligjit. Kështu që, në lidhje me këtë, më shqetëson më tepër jo përfundimi por çështja se si mundet një komision që nuk ka kompetencë të bëjë interpretimin përfundimtar të ligjit dhe ia dërgon KED-së ta ketë parasysh se mos marrë ndonjë vendim tjetër.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe shprehet se në cilësinë e përfaqësuesit të Presidentit të Republikës, si organ emërtese dhe si organ që ka organizuar shortin për përzgjedhjen e anëtarit të KED të këtij viti, duhet së pari ti uroj suksese. Dhe së dyti dua të jap një përshtkrim historik në lidhje me përgatitjen e listave apo vetë procesin e hedhjes së shortit dhe më pas mbi një qëndrim, të paktën timin profesional, me aq sa e kuptoj unë Kushtetutën dhe ligjin, mbi statusin e zonjës Marku.

Për këtë çështje, hartimin e listave dhe përcjelljen e tyre pranë organeve që hedhin shortin, është e vërtetë se ligji ka disa hapësira ose vakume të cilat lënë mënyra të interpretimit të zgjeruar të cilat mund të sjellin edhe gabime. Një prej tyre është që organet që propozojnë listat, KLGJ, KLP apo Gjykata Kushtetuese, kanë për detyrim që deri në datën 05-10 Nëntor të sjellin listat tek Presidenti dhe Kuvendi. Por, është po ligji, që thotë se në momentin e hedhjes së shortit kandidati duhet të plotësojë kriteret dhe kushtet. Pra, është një diapazon prej 20 ditësh brenda të cilit ndodhin ngjarje, rrethana dhe fakte të cilat bëjnë që një kandidat ta humbasi statusin e kandidatit dhe ne të paktën, Presidenti i Republikës u tregua aktiv në këtë proces duke konfirmuar në mënyrë thuajse të përditshme me KLP-në dhe KLGJ-në listat e kandidatëve, Na rezultoi që, të paktën nga KLGJ-ja, 5 gjyqtar u përjashtuan nga shorti. Mund të ndodhte me këtë Këshill që një gjyqtari të tillë ti binte shorti dhe të ishte këtu. Kjo u shmang nga Presidenti. Edhe ky proces u monitorua nga Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr.115/2016. Vetë zoti Spahiu ka qenë prezent në orën 12 kur është hedhur shorti, madje me autorizim të Presidentit, me kërkesën e tij ka përzgjedhur një prej goglave, për një nga kandidatët. Ky Komision ka hartuar edhe një raport monitorimi i cili e nxjerr procesin tepër transparent dhe korrekt, por që mban të njëjtën, unë besoj që është rastësi, numërtesë 26/2020 si vendim më të cilën është miratuar 26 përmban dhe ky tjetri që është 2019, për miratimin e hedhjes së shortit. Gabim administrativ do besoja por gjithsesi është këtu.

Shkresa e zonjës Marku në vetvete nuk është një kërkesë, është një shfaqje qëndrimi. Unë nuk shikoj objekt. I ka bërë me dije Këshillit pse nuk jam sot prezent dhe ka kërkuar

shprehjen e vullnetit prej tij. Nëse do të hyja në dispozitat kushtetuese krahesuar me ato të ligjit nr.115/2016, mendoj që Kuvendi e ka pasur mirë parasysh që ky Këshill, për vetë fuqinë që ka dhe çfarë zgjedh, kandidatët në Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, nivelin e përfaqësimit duhet ta ketë edhe të balancuar edhe të lartë. Ligji përcakton nga Prokuroria e Përgjithshme 1 anëtar + 1 zëvendësues, nga Prokuroria e Apeleve po ashtu. Në momentin që zonja Marku merr statusin e një prokurore pranë Prokurorive të Apeleve humbet statusin e përfaqësimit në Këshill nga Prokuroria e Përgjithshme, por humbet dhe zbalancon e shkon tek....(ndërhyrje pa mikrofon)edhe statusin e përkohshëm, përkohshmërinë sa e ka, pra e zbalancon duke e çuar tek Prokurorit e Apeleve. Kështu që duhet të vlerësohet edhe kjo gjëndje që krijohet nga ky veprim emërtese që ka vendosur Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Por në orën 12 kur është hedhur shorti deri në 13.30 duhet të shikojmë pak s'esi janë zhvilluar situatat në kohë. Ne zhvillonim shortin nga njëra anë dhe seanca plenare kishte filluar për të votuar Prokurorin e ri të Përgjithshëm. Shorti përfundoi në orën 13.30 kurse Prokurori i Përgjithshëm në orën 15.30. U zgjodh zoti Olsion Çela dhe po atë ditë, pas gjysëm orë, është bërë edhe betimi i tij. Pra, Prokurori i Përgjithshëm brenda të njëjtës ditë u zgjodh dhe hyri në ushtrimin e funksionit të tij. Ndërkohë që mandati i zonjës Marku për ta ushtruar në këtë Këshill do të fillonte në 1 Janar 2020. Dhe këtu në mënyrë të papritur hyn një komision, i cili vërtet ka një punë të përcaktuar me vendim të Kuvendit, por duhet të monitoroj një veprimtari dhe pastaj të bëjë një raport. Këtu nuk ka veprimtari të monitoruar. Pra, duhet të ndodhte si problem, të evidentohej, të bëhej një raport dhe tja çonte Kuvendit. Ta zgjidhte këtë hapësirë apo këtë boshllëk ligjor, jo t'ia sillte KED-it, i cili do të shqyrtojë po zotin Spahiu, 1/6 pjesë të këtij Komisioni, se si do të renditet me pikë si kandidat për anëtar në Gjykatën Kushtetuese. Më duket jo normale kjo pozitë.

Problemin e hedhjes së shortit përgjatë vitit duhet ta sjellim në kujtesë se ka qenë një problem që e shqetësonte edhe Ministrinë e Drejtësisë, edhe Qeverinë, e cila ka kërkuar pranë Presidentit hedhjen e shortit përgjatë vitit 2018, me argumentin se KED i atij viti ka humbur kurumin, gjë që nuk ishte e vërtetë. Humbja e kuorumit nga KED 2018 ka ndodhur në 10 Tetor. Pra, KED 2018 ka pasur kuorum vendimmarrës me 5 anëtar deri në atë moment. Ka pasur një investim të Kryetarit të Kuvendit me shkresë, ka pasur dhe një përgjigje të Presidentit, ku i është thënë se mungon hapësira kushtetuese dhe ligjore që të hedhim short përgjatë vitit. Kështu që i është kërkuar Kuvendit të investohet me veprimtarine parlamentare që të plotësojë ligjin 1 vit e gjysëm përpara dhe Kuvendi nuk ka dashur ose nuk ka shfaqur vullnet që ta bëjë këtë. Mos është momenti që ta realizojë nisur dhe nga fakti që KED në datën 30.12.2019 miratoi një raport i cili përmban në fund të tij një paragrafë ku i jepet

Kuvendit një kërkesë për rishikimin e disa problematikave të ligjit. Një prej tyre është evidentuar nga unë vetë, personalisht, pikërisht kjo. Kështu që, ky raport do ti vlente Kuvendit më mirë dhe jo KED-it. Zonja Marku ta vlerësoj personalisht vetë, por unë si jurist e vlerësoj që në momentin që humbet funksionin bazë ke humbur dhe funksionet e tjera që delegojnë dhe burojnë prej tij. Mund të ndodhemi në një situatë që kjo gjë mund të përsëritet në Këshill edhe për anëtarë të tjerë. Psh hipotetiki, merret një masë disiplinore ndaj një anëtari të Këshillit me uljen në gradën e funksionit që mban. A qëndron besimi plotësisht tek ky që ka marrë një masë disiplinore? Pra, është një hapësirë boshe e ligjit për të cilën Kuvendi investohet menjëherë dhe unë falenderoj edhe deputetin e opozitës që ka ardhur sot prezent për ta rregulluar si normë menjëherë.

Korab Lita merr fjalën dhe shprehet se fillimisht dua ti uroj punë të mbarë këtij institucioni. Nuk kam një qëndrim prej eksperti pasi nuk mendoj se jam në vendin e duhur ose në pozicionin e duhur si anëtar i KED-së, por do të doja që kjo të shikohet pak me kujdes që të mos krijohet precedent për mbledhjet e ardhshme ose për anëtarët e tjerë. Pasi siç dihet në Shqipëri shumë institucione janë në formim e sipër dhe ky precedent që është sot mund të ndodhë edhe herë të tjera. Kështu që, në këtë këndvështrim duhet parë me kujdes.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pas diskutimit nga anëtarët e KED, fjalës së pjesëmarrësve të tjerë në mbledhje dhe qëndrimeve të anëtarëve për pikën e parë të rendit të ditës, me konstituimin e KED, orienton diskutimin në tre pikat e tjera të rendit të ditës.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani relaton se dy pikat e para të rendit të ditës, të cilat kanë më shumë karakter informues.

Në lidhje me pikën e dytë të rendit të ditës, për çështjen e mbështetjes administrative të KED nga Gjykata e Lartë, nëpërmjet materialit me shkrim parashtrihen në mënyrë të përmbledhur parashikimet për ngarkesën e punës së KED për vitin 2020, me tre vende vakante në Gjykatën Kushtetuese në proces, për dy prej të cilave është punuar edhe në muajt e fundit të vitit 2019. Njëkohësisht, gjatë vitit do të jenë në proces 2 procedura për shpalljen e vendeve vakante me mandat të plotë dhe 2 procedura për vakanca të parakohshme në Gjykatën Kushtetuese për të cilat organ emërtuese është Gjykata e Lartë. Ndërkohë nuk përjashtohet mundësia që gjatë vitit të lindë nevoja e rishpalljes së vakancave për mungesë kandidatësh të lejuar për kandidim.

Gjitashtu, kërkohet mendimi apo mbështetja e Këshillit për kryetarin, i cili, sipas ligjit, ka përgjegjësinë dhe kompetencën që duhet ti drejtohet me kërkesat përkatëse Gjykatës së Lartë, kjo edhe në kushtet e pazakonta kur është i njëjti person në cilësinë e kryetarit të KED dhe titullarit të Gjykatës së Lartë. Propozohet që për të përballuar në kohë dhe me

efektivitet punët, veçanërisht me zbardhjen e procesverbaleve, të dyfishohet menjëherë numri i punonjësve të sekretarisë së Gjykatës së Lartë në mbështetje të veprimtarisë së Këshillit.

Marsida Xhaferllari ndërhyt dhe shtron pyetjen se a do të bëhet kërkesë KLGJ-së për organikën e Gjykatës së Lartë dhe së dyti për sa kohë ekzekutohet kërkesa e KED drejtuar Gjykatës së Lartë për të shtuar personelin mbështetës për KED?

Ardian Dvorani sqaron dhe shpjegon se kërkesat janë parashtuar tashmë. Jo vetëm për shkak të situatës së jashtëzakonshme e të nevojave emergjente me të cilat përballet, por edhe për një situatë normale pune, edhe vetë organika e Gjykatës së Lartë për pjesën e sekretarisë është e pamjaftueshme. Ndërsa kërkesa e KED për mbështetje me personel nga Gjykata e Lartë realizohet dhe plotësohet brenda 24 orëve. Sigurisht që ka edhe disa efekte financiare e buxhetore shtesë kur merret personel mbështetës për Këshillin, por që nuk janë problem i veçantë. Prandaj, nëse Këshilli përkrah propozimin, menjëherë procedohet me shkresë dërguar në emër të KED, e cila pasohet me nxjerrjen e urdhërit për të caktuar 3 (tre) punonjëse shtesë të Gjykatës në mbështetje të veprimtarisë së KED.

Ludovik Dodaj merr fjalën dhe duke u shprehur se nuk është në dijeni të praktikës së ndjekur vitin e kaluar dhe të ndonjë dispozitë që ta parashikojë, meqenëse është e domosdoshme të konsiderohet, cili duhet të jetë trajtimi i anëtarit të KED jo në aspektin financiar por në atë të ngarkesës së punës që duhet të përballojë?

Ardian Dvorani sqaron dhe shpjegon se për anëtarët e KED dhe personelin administrativ përcaktohet edhe një trajtim financiar sipas legjislacionit në fuqi. Anëtarët e Këshillit kanë një shpërblim mujor si anëtarë të organit kolegjal me kohë të pjesshme, ndërsa personeli administrativ një % shtesë mbi pagën e tyre. Nga ana tjetër, sikurse vitin e kaluar, KED i drejtohet me shkresë KLGJ-së dhe KLP-së, me të cilën i kërkon që të aplikojnë, sipas hapësirave që parashikon ligji, uljen e ngarkesës së tyre të punës. KLGJ ka vepruar dhe ka aplikuar lehtësim ngarkese, ndërsa KLP jo. Edhe për këtë vit do të procedohet menjëherë me dërgimin e shkresa përkatëse këtyre dy institucioneve.

Saida Dollani merr fjalën dhe shprehet se është i nevojshëm një sqarim për ta kuptuar edhe e më mirë pikën e dytë të rendit të ditës. Në këtë pikë, kërkohet votimi apo është thjesht veprim konsultativ sepse në bazë të ligjit mbështetja administrative është kompetencë e Kryetarit të Këshillit, në bashkëpunim me kryetarin e Gjykatës së Lartë? Pra, çfarëdo lloj vendimi dhe si do që të votoj e kam votën të pavlefshme sepse sipas ligjit është kryetari i Këshillit dhe Kryetari i Gjykatës së Lartë që vendosin për personelin.

Ardian Dvorani sqaron dhe shpjegon se sikurse edhe në vitin e kaluar në rastet e kërkesës dhe shtesës së mbështetjes administrative, KED nuk ka marrë vendim të posaçëm,

në kuptimin formal. Sigurisht, që është e drejtë dhe detyrim i kryetarit të Këshillit të sigurojë mbështetjen dhe të komunikojë me Gjykatën e Lartë. Por çështjet dhe problemet e administrimit duhet të ndahen me Këshillin dhe sigurisht të kërkohet një mendim sepse kryetari mund të gjykojë së mbështetja është e mjaftueshme por në fakt nuk është e mjaftueshme. Prandaj, mbi bazën edhe të mendimit të Këshillit, kryetari mund të procedojë menjëherë me procedurat e sigurimit të mbështetjes administrative nga Gjykata e Lartë.

Marsida Xhaferllari merr fjalën dhe sugjeron që meqënëse buxheti i Gjykatës së Lartë hartohet, planifikohet dhe përcillet për miratim nga KLGJ-ja, të ndiqet kjo rrugë edhe për nevojat e buxhetit të KED, pra jo nga Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Ministrave, duke u stakuar nga këto dy degë të pushtetit.

Ardian Dvorani, në lidhje me këtë sugjerim, sqaron se në vitin 2019, në fillim të veprimtarisë së tij, KED kuptoi që ngarkesa e punës do të ishte përtej asaj të zakonshme dhe përtej pritshmërive për veprimtarinë normale të KED sipas Kushtetutës dhe ligjit. Pra ishte e dukshme nevoja për fonde buxhetore, jo vetëm për shpërblimet apo shtesat e pagave, por edhe për shpenzimet e ndryshme të procedurave të verifikimit dhe të vlerësimit të kandidatëve. Prandaj nevojat për buxhet të KED u plotësuan me një vendim qeverie nga fondi i posaçëm për sistemin e drejtësisë sepse nuk ishin parashikuar fonde për këto qëllime në buxhetin e Gjykatës së Lartë. Ndërsa për vitin 2020 është proceduar në rrugën e zakonshme, nëpërmjet buxhetit të propozuar për KED, të pranuar dhe përcjellë nga Gjykata e Lartë dhe të shqyrtuar e përcjellë për miratim sipas ligjit në kuadër të buxhetit të pushtetit gjyqësor. Pritet të paraqitet vetëm detajimi i buxhetit të miratuar.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe parashtrohet se kjo është një çështje shumë e rëndësishme, e cila, pavarësisht se diskutohet në mbledhjen e parë të Këshillit, është një çështje e cila do ta ndjek Këshillin gjatë gjithë veprimtarisë së tij. Staf i cili duhet të jetë në mbështetje të Këshillit duhet të jetë i menduar mirë dhe duhet të jetë i mjaftueshëm që ky Këshill ta kryejë në përputhje me ligjin detyrën e tij. Nëse vitin e kaluar kemi pasur disa mangësi për mosveprim në përputhje me ligjin, duke mos pasur kohën e mjaftueshme, duke mos pasur dokumentet e mjaftueshëm, fotokopje të mjaftueshme, pra shumë veprime që na kanë çuar që të gjithëve, mua të parën, nuk di ndoshta anëtarët e tjerë, pothuajse në pamundësi për të parë në mënyrë të thelluar dosjet e kandidatëve, por vetëm duke lexuar relacionet, ka qënë për shkak se ka pasur pamundësi stafi dhe përgatitje materiale për anëtarët, gjykoj dhe për të ftuarit apo për vëzhguesit.

Problematika tjetër që duhet ngritur në këtë mbledhje është se sa është kosto financiare e këtij Këshilli? Unë nuk e di si vëzhguese në veprimtarinë e Këshillit, nuk kishte

pjesë për çështjet financiare edhe në raportin vjetor. Sigurisht që duhet të kuptojë secili prej nesh vlerën dhe impenjimin që ka buxheti i shtetit për këtë institucion. Duhet që të kemi sekretarë të mjaftueshëm për zbardhjen e procesverbaleve sipas ligjit dhe sipas rregulloreve. Procesverbalet zbardhen menjëherë. Duhet të vendosni a do të ketë vetëm një procesverbal përmbledhës që zbardhet apo do të ketë edhe procesverbale të tjera? Do të zbardhet vetëm procesverbali audio dhe nuk do të ketë më procesverbale për tu miratuar? Kjo është një çështje që gjithashtu lidhet edhe me numrin e sekretarëve, punën e dedikuar të sekretarisë në lidhje me këtë çështje, nëse do të duhet të ketë pajisje të posaçme për të mbledhur, ruajtur dhe zbardhur informacionin. Këto duhet të jenë pjesë e kërkesave buxhetore që të ketë dokumentim të duhur ligjor të atyre që kanë ndodhur në Këshill, të ketë mundësi që secili prej nesh ti konsultojë ato sepse mbledhja është e mbyllur. Por për anëtarët nuk është e mbyllur, të paktën për pjesa e vendimmarrjeve dhe sigurisht edhe mënyra se si këto informacione mbahen nga ana e tij të jetë e saktësuar në rregulloret e Këshillit. Ndoshta do të ishte me vend që Këshilli të kishte të qartë se sa ka qënë kërkesa që kemi bërë në buxhet që vitin e kaluar sepse këto nuk ndodhin brenda vitit. Kërkesat buxhetore unë i filloj që në mars të vitit 2019 për 2020-ën. Kështu që është një gjë që shtrohet për mendim dhe Këshillit duhet ti thuhet buxheti që kemi menduar dhe që shpresojmë të jetë i mjaftueshëm.

Unë mendoj që edhe numri këshilltarëve duhet të ishte në pyetje. Është e pamundur për me këtë numër që këshilltarët të paraqesnin në kohën e duhur dhe me kujdesin e duhur materialet e dosjeve për anëtarët dhe trajtimin e problematikave që kishim. Të paktën insitucionit të Avokatit të Popullit i kanë ardhur gjithmonë me vonesë, jashtë afatit 5 (pesë) ditor, me mijëra faqe dokumenta që do duhet të kishte shqyrtuar dhe të jepte një qëndrim për një afat shumë të shkurtër, 1 (një) ditë, 2 (dy) ditë dhe 3 (tre) ditë. Ju e dini shumë mirë që e kemi diskutuar këtë çështje në Këshill. Nuk e di se si anëtarët e tjerë e kanë realizuar vënien në dijeni të informacioneve, si kanë marrë kopjet e materialeve të dosjeve të relatuar apo ato kanë qënë në sekretari dhe secili prej anëtarëve mund të shkonte ti verifikonte në sekretarinë e KED. Nuk e di nëse ky Këshill do të proçodoj në të njëjtën mënyrë. Por mua më duket një mënyre jo efektive sepse edhe vetë personalisht e kam të pamundur të shikoj mijëra faqe dokumenta dhe besoj që si unë edhe anëtarët e tjerë të Këshillit do të kenë po të njëjtën çështje kohore për sa i përket verifikimit të dokumenteve. Vërtet ka një relator për çështjet, por secili prej jush që keni për të votuar, votën e tij do ta japi mbi bazën e vlerësimit të tij mbi këto materiale dhe jo mbi bazën e mendimit të relatorit. Këto ishin pak a shumë disa çështje të cilat unë po i ngre sepse i kemi pasur problem në vitin e kaluar, i kemi trajtuar dhe debatuar. Sigurisht jemi munduar që në ato kushte të jashtëzakonshme emergjence, ju si

kryetar, anëtarët e Këshillit dhe ne për atë rol dhe kompetencë që na ka dhënë ligji, jemi munduar të bëjmë maksimumin e mundshëm për ta bërë punën me përgjegjësinë më të madhe të mundshme. Duke qenë se kemi këtu dhe anëtar nga Komisioni i Ligjeve, të cilët sigurisht kanë një rol shumë të madh në buxhetimin e organeve të drejtësisë, ata duhet ta kuptojnë dhe mund ta kuptojnë më mirë kur janë vetë dhe shikojnë sasinë e jashtëzakonshme të punës që ky Këshill ka përballuar në vitin e kaluar, ndaj ne duhet ti ngremë këto problematika edhe njëherë dhe tua identifikojmë këto problematika se ata nuk e mendojnë që ekzistojnë dhe i kemi hasur në vitin e kaluar.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pas mendimeve të dhëna nga anëtarë të KED dhe pjesëmarrës të tjerë në mbledhje për pikën e dytë të rendit të ditës, orienton vijimin e mbledhjes me shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës mbi informimin e Këshillit për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese që shqyrtohen gjatë vitit 2020. Nëpërmjet materialit me shkrim parashtrohet, në mënyrë të përmbledhur, se janë 3 (tre) vakanca të parakohshme në Gjykatën Kushtetuese të shpallura dhe me dokumentacion të administruar pranë KED. Vakanca e parakohshme e rishpallur nga Kuvendi, ku janë 6 (gjashtë) kandidatë për të cilët procedura e verifikimit është e avancuar. Vakance e parakohshme e rishpallur nga Presidenti i Republikës, ku janë 8 (tetë) kandidatë dhe veprimet e procedurës së verifikimit janë në një fazë të avancuar për më shumë se gjysmën e kandidatëve. Do të jenë relatorët e rinj që do të përcaktojnë ecurinë e mëtejshme të procedurës së verifikimit. Në vendin tjetër vakant, vakancë e parakohshme, e shpallur nga Presidenti i Republikës pas mbarimit të parakohshëm të mandatit të gjyqtarit Besnik Muçi, janë 10 (dhjetë) kandidatë. Dokumentacioni ka mbërritur në 27.12.2019 dhe duhet të organizohet short për caktimin e relatorit. Janë edhe 3 (tre) vende vakante me organ emërtese Gjykatën e Lartë. Për vakancën e parë shpallur në vitin 2017, ka pasur tre kandidatë, por janë tërhequr dy kandidatë. Shaplljet dhe rishpallja për të tre vakancat që ka bërë Gjykata e Lartë nuk kanë sjellë ndonjë zgjidhje të situatës sepse ose nuk ka kandidime ose numri i kandidimeve është më i vogël se 3 (tre). Meqenëse lidhet me situatën e vendet vakante me organ emërtese Gjykatën e Lartë i është dërguar shkresë KLGJ-së duke i kërkuar informacion lidhur me parashikueshmërinë e tyre se kur mund të ndodhë plotësimin i kuorumit të Gjykatës së Lartë sepse për momentin ka vetëm një gjyqtar në detyrë dhe një tjetër që ushtron funksionet pranë KLGJ-së. Përgjigja zyrtare do të jetë pjesë e diskutimit dhe vlerësimit për vendimet që KED për ti kërkuar Gjykatës së Lartë rishpalljen e vakancave. Për tu vlerësuar rasti kur pas rishpalljes, nëse do të ketë kandidatë dhe KED i kryen procedurat e lejimit deri në renditje, a do ta mbajë renditjen pa e dërguar në kushtet kur nuk ka kuorum ligjor në Gjykatën e Lartë?...

Marsida Xhaferllari ndërhyt dhe shtron pyetjen se pse a nuk vepron mekanizmi zhblllokues?

Ardian Dvorani sqaron se mekanizmi zhblllokues në këtë rast është që ti dërgojmë renditjen Gjykatës së Lartë e cila nuk ka gjyqtarë që të organizojë mbledhjen dhe votimin. Mund të jetë kjo një nga diskutimet. Pra kërkohet që zyrtarisht të informohemi kush do të jetë numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë dhe parashikueshmëria e tyre plotësimin e tyre. Prezumohet numri 19 por nuk ka vendim sipas ligjit.

Saida Dollani ndërhyt dhe shtron pyetjen për çfarë i është kërkuar informacioni? Ku janë me shpalljen e vendeve vakante në Gjykatën e Lartë?

Ardian Dvorani sqaron se pyetja lidhet me situatën kur 3 (tre) vende vakante të Gjykatës Kushtetuese plotësohen nga Gjykata e Lartë. KED duhet të procedojë duke e njoftuar dhe pas kësaj Gjykata e Lartë me rishpallje. KLGJ-së i kërkohet të njoftojë zyrtarisht se kush është numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Kjo rrethanë mund edhe të injorohet, por mirë është të jemi në djeni sa do të jetë numri i tyre, kush është parashikueshmëria në kohë për ti plotësuar dhe sa mund të plotësojnë nga ky numër....

Marsida Xhaferllari ndërhyt dhe shpjegon se është fakt publik që numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë ka qënë i caktuar me ligj 19 (nëntëmbëdhjetë) gjyqtarë dhe gjithashtu nga ligji është thënë që kompetenca e caktimit të numrit të gjyqtarëve i takon KLGJ-së. Për sa kohë KLGJ nuk kanë marrë vendim, numri është 19 (nëntëmbëdhjetë). KLGJ ka shpallur 4 (katër) vende vakante në Gjykatën e Lartë duke zbatuar ligjin që parashikon se 20 % e numrit të gjyqtarëve janë nga rradhët e juristëve. Pra ju e dini që numri është 19 (nëntëmbëdhjetë). Kështu që kjo kërkesë jep mesazhin se po kërkohet të zvarritet diçka në këtë proces dhe mund të bëhet objekt kritike për zvarritje të procesit të ngritjes dhe funksionalitetit të Gjykatës Kushtetuese. Kandidatë mund të vijnë dhe ngrihet apo nuk ngrihet Gjykata e Lartë për këtë arsye është mekanizmi zhblllokues që të bëjë të funksionojë një situatë të bllokuar.

Ardian Dvorani sqaron se mendojmë se numri i gjyqtarëve është 19 (nëntëmbëdhjetë). Por është KLGJ-ja që duhet të na informojë zyrtarisht sipas ligjit dhe nuk ka asnjë qëllim tjetër. Mund të vlerësohet i parëndësishëm si informacion dhe KED të procedojë por duhet të njohim situatën. Interpretimit i mekanizmit zhblllokues në këtë rast është një diskutim tjetër i cili merr disa kahje dhe interpretime.

Saida Dollani ndërhyt dhe shtron pyetjen është shfuqizuar ai ligj?

Ardian Dvorani sqaron se ligji për Gjykatën e Lartë është i shfuqizuar. Por nisur nga veprimet që kanë ndodhur dhe vendimmarrje për efekte të tjera mendojmë që KLGJ mban parasysh numrin 19 (nëntëmbëdhjetë) gjyqtarë përderisa kanë bërë 4 (katër) shpallje për

vende vakante në Gjykatën e Lartë, por zyrtarisht nuk është vendosur dhe nuk është njoftuar asnjëherë.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe parashtron se sa i takon emërimit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë kemi qënë edhe ne në një komunikim, përderisa anëtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti me dekret pas propozimit të KLGJ-së. Edhe ne si insitucion kemi pasur shqetësim të lartë bllokimin e veprimtarisë së Gjykatës së Lartë sidomos pas momentin kur edhe kryetari i saj, zoti Zaganjori, humbi funksionin për shkak të procesit të vetting-ut dhe tashmë ka një periudhë më shumë se 6 (gjashtë) mujore që e gjithë barra dhe përgjegjësia e organizimit të punëve brenda Gjykatën e Lartë, ku përfshihet dhe mbështetja e Këshillit, ka qënë në përgjegjësinë e të njëjtit person që mban dhe 2 (dy) funksione, kryetarit të KED-it dhe kryetarit në detyrë të Gjykatës së Lartë. Nga komunikimi që kemi pasur me KLGJ-në, të paktën kjo daton në muajin gusht, ku i është kërkuar informacion shterues mbi ecurinë e procesit, na është bërë me dije që sapo kemi përfunduar hartimin e akteve nënligjore, do të bëjmë shpalljen menjëherë dhe shumë shpejt do të vijnë propozimet pranë institucionit të Presidentit të Republikës. Deri më sot nuk ka asnjë propozim. Ditën e premte, javën e kaluar ne kemi ripërsëritur një kërkesë ndaj tyre për të thënë që ku është faza e shqyrtimit, vlerësimit, pikëzimit të kandidatëve dhe për sa pozicione. Pasi nuk duhet ta fshehim se ato pozicione që vijnë nga jashtë sistemit gjyqësor afektojnë edhe mandatet të anëtarëve aktualë të Gjykatës së Lartë. Kështu që do të jetë një çështje për tu diskutuar dhe e vështirë.

Më vjen mirë që kryetari në detyrë i Gjykatës së Lartë, aktualisht edhe kryetar i KED-së, në pikën pararendëse të rendit të ditës tha që do të ofrojmë mbështetje për Këshillin me një shtesë në organike brenda 24 orëve. Unë do të isha shumë i lumtur që kjo të kishte ndodhur dhe në Këshillin e kaluar, për të mos kaluar në ato diskutime dhe çështje shumë problematike që u shfaqën në zbardhjen e procesverbaleve që ngelën pa u zbardhur në 12 (dymbëdhjetë) muaj. Dhe këtu do të tërheq vëmendjen e të gjithë Këshillit që mbledhja e ardhshme duhet të fillojë sipas Rregullores me miratimin procesverbalit të mbledhjes së kaluar dhe bërjen e tij publike siç e ka rregulli.

Përpara hedhjes së shortit për këto 3 (tre) vakanca, që janë 2 (dy) të Presidentit dhe 1 (një) e Kuvendit, konstatojmë nga përbërja e listave të kandidatëve që këtu kemi kandidatë nga sistemi gjyqësor dhe një kandidat nga sistemi prokurorisë, nga të cilët, një prej tyre ka kaluar vetting-un në shkallë të parë, ndërsa një tjetër, nuk më kujtohet që të ketë kaluar në vetting. Kjo do të lindi sërish të njëjtën problematikë që kemi pasur vitin e kaluar....

Ardian Dvorani ndërhyt dhe sqaron se kandidati prokuror e ka kaluar vetting-un me vendim të formës së prerë. Ndërsa rasti i kandidates Regleta Panajoti është në shqyrtim nga KPA.

Bledar Dervishaj vijon fjalën dhe parashtron se zonja Panajoti ndodhet në KPA, njësoj siç ndodhej edhe zoti Besnik Muci. Për fat të mirë, për ne që kemi pretenduar që vendimmarrja e Këshillit do të orientohet nga vetting-u i përfunduar me formë të prerë, kjo çështje parimore, kuptohet në një çështje konkrete, nuk na solli aspak shpejtësi në Gjykatën Kushtetuese funksionale, por na solli vonesë dhe ne kemi kërkuar me forcë që ky rregull i përcaktuar në vendimet nr.3 dhe nr.4 të KED, sipas të cilit Këshill konsideron të kandidueshëm për të vijuar me pikëzim dhe vlerësim, një kandidat me vendim të shkallë të parë, duhet të rishikohet nga Këshilli sepse mund të ndodhemi në të njëjtën situatë dhe do të prodhojmë sërish të njëjtën vonesë. Kështu që në mbledhjen e ardhshme....

Ardian Dvorani ndërhyt dhe informon se i është dërguar shkresë KPA-së meqenëse kanë ndryshuar rregulloren e tyre para disa muajsh dhe i trajtojnë me përparësi rastet nëse ka kërkesa të motivuara nga institucionet. Është që zonja Panajoti, si një nga kandidatet për Gjykatën Kushtetuese, sipas rregullave të tyre të futet në procedura për tu shqyrtuar menjëherë.

Bledar Dervishaj vijon fjalën dhe parashtron se me sa duket për një rregullore të KPA-së apo KPK-së është riskuar edhe vet një kandidat të ishte me vendim të formës së prerë por kjo nuk erdhi nga ata, erdhi nga Këshilli që duhet të kishte pritur këto dy organe për formë të prerë. Kështu që mendoj se Këshilli është momenti që ta rimarrë në diskutim patjetër këtë akt nënligjor. Për të mos kaluar pastaj tek një akt tjetër nënligjor mbi pjesmarrjen e Avokates së Popullit në të gjithë veprimtarinë e Këshillit, pra edhe në atë që konsiderohet dhomë këshillimi. Konsiderohet dhomë këshillimi sepse largohem unë edhe Avokatja e Popullit. Kështu që edhe në këtë drejtim do ta ftoj Këshillin që në mbledhjen e ardhshme të përfshijë në rendin e ditës edhe këto dy pika për diskutim. Edhe për të vetmin fakt se sot kemi një padi të ngritur nga Avokatja e Popullit pranë Gjykatës Administrative për këto dy akte dhe shtyrja apo bërja publik i procesit që ma do mendja do të ndiqet me interes, nuk do të bëjë gjë tjetër vetëm se do të vendosë në diskutim menjëherë edhe besimin e veprimtarisë së Këshillit.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe parashtron se po të mbani mend herët e kaluara nuk u rishikua kur kërkohej rishikimin e këtij vendimi nga ana e Këshillit. Këshilli u shpreh se duke qënë se ka filluar procedura e verifikimit të kandidatëve nuk mund të ndryshojmë rregullat në procedurë e sipër dhe prandaj nuk mundemi të kemi vendimmarrje në lidhje me

këtë çështje sepse nuk do të kemi një proces të rregullt ligjor ndaj kandidatëve. Tani unë jam duke e tërhequr vëmendjen e Këshillit për këtë çështje sepse nuk kam qenë dhe nuk e di se çfarë ka ndodhur, por kemi pasur ndryshime të qëndrimit të vendimmarrjeve për këtë shkak. Ndoshta dhe kryetari do duhet ti relatojë Këshillit që është një padi e ngritur dhe që nesër është seanca.

Marsida Xhaferllari merr fjalën dhe pas diskutimit shtron kërkesën që të mos fillojmë me procedurën e shortit pa diskutuar mbi rregullat, mbi kuadrin ligjor sepse tre çështjet e para ishin konstituimi, mbështetja administrative e Këshillit dhe informacion për vendet vakante. Ndërsa tani fillojnë çështjet e procedurës. Në cilësinë e anëtares zëvendësuese kam detyrim ligjor të jap opinion për aktet nënligjore të Këshillit për të cilin kam nisur ditën e djeshme e-mail se do të kërkoj zyrtarisht rishikimin e pjesshëm të akteve nënligjore të Këshillit. Në këtë moment, pas konstituimit dhe përpara fillimit të procedurave konkrete riparaqes kërkesën që një pjesë e rregullave nënligjore të rishikohen. Nëse jepet kohë janë një grup çështjesh që mund të paraqes formalisht propozimin për rishikimin e një pjese të akteve nënligjore. Edhe vetë vendimi për procedurën e shortit, përpara se të procedohet me short manual, kërkon që formalisht të merrni një informacion nga IT.

Ardian Dvorani ndërhyt dhe sqaron faktin që ka raport teknik nga sektori IT për këtë qëllim, por u mendua si veprim rutinë sepse nuk është hera e parë, kemi të njëjtën gjendje dhe kemi të njëjtin raport teknik. Kush ka sugjerime dhe propozime le ti bëjë më konkrete me shkrim t'ju shpërndahen të gjithëve për të vlerësuar diskutimin e tyre. Por kjo nuk e pengon procedurën e shortit për përcaktimin e relatorit. Relatorët në çdo lloj situatë do të marrin detyrën, do të bëjnë verifikimet dhe kjo kërkon kohë. Nuk kemi hyrë akoma në mbledhje për të shqyrtuar verifikimin, vlerësimi, dhe se si do bëhet renditja e kandidatëve. Ndryshe do të humbet kohë dhe KED për vitin 2020 nuk e ka luksin e kohës sepse Gjykata Kushtetuese është pjesërisht funksionale.

Marsida Xhaferllari, Ardian Dvorani dhe Saida Dollani diskutojnë për vijimin ose jo të mbledhjes me pikën e katërt të rendit të ditës që parashikon procedurën e shortit për caktimin e relatorëve për tre vendet vakante, nëse mbledhja duhet të ndërpritej pas konstituimit dhe a duhet të shtyhej që të zbatohen rregulla për njoftimet për krijimin e rendit të ditës, njoftimin e akteve, duke përfshirë këtu dhe informacionin për shortin elektronik nuk funksionon, nëse mbledhja duhet të ndërpritet për ti dhënë kohë anëtarëve të paraqesin propozime për ndryshime në aktet nënligjore të cilat të shqyrtohen në mbledhjen e ardhshme apo të vijohet me realizimin e procedurës së shortit dhe njëkohësisht të anëtarët të bëjnë propozime për ndryshime në aktet e Këshillit për tu shqyrtuar në mbledhjen e ardhshme.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe shprehet se, së pari, hedhja e shortit është një problem që e kemi evidentuar edhe në mbledhjet e Këshillit të kaluar. Është e vërtetë që në Këshillin e kaluar ka ardhur një raport nga ana e IT të Gjykatës së Lartë i cili shpjegon se është i pamundur realizimi i shortit elektronik. Por nuk e dimë se çfarë ka bërë më tej Këshilli apo dhe Gjykata e Lartë për ta ndryshuar, nëse është bërë kërkesë për fonde për ta ndryshuar problematiken në mënyrë që Gjykata e Lartë të asistojë sipas ligjit KED-in të kryejë shortin elektronik. Nëse nuk do të kishte mundësinë ky Këshill të realizonte shortin elektronik, të paktën në sytë e publikut do të ishim të qartë që kishim tentuar dhe kishim marrë masat për të realizuar sipas parashikimit ligjor që shorti të jetë elektronik dhe jo manual. Së dyti, tërheq vëmendjen se Këshilli nuk ka bërë asnjë procedurë vjet pa përfunduar të gjitha rregulloret, jo vetëm rregulloren bazë. Pastaj u hodh shorti dhe filluan veprimet. Nëse do të ketë amendamente të rregullave nga Këshilli kjo duhet që të bëhet përpara se të kalohet në procedurën e shortit, pikërisht për të mos shkuar në ato pretendime që ju vetë zoti kryetar i keni pasur në procedurat e kaluara, duke thënë se për sa kohe kishin filluar procedurat e verifikimit nuk mund të bëheshin ndryshime në rregullore. Ka qenë një nga shkaqet që keni ngritur, përtej shkaqeve të tjera, kur kam kërkuar të rihidhet në votë ai parashikim i rregulloreve që në gjykimin tim është në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin. Është e vështirë për Këshillin që në mbledhjen e parë të marrë vendime kaq të rëndësishme, por do të doja që secili prej anëtarëve të Këshillit të shprehet dhe të informohet mbi ato që mund të krijohen ose mund të jenë problematika në një moment të dytë.

Ardian Dvorani merr fjalën dhe sqaron se informacioni me shkrim, raporti teknik i IT është i njëjti, identik me herët e tjera, në lidhje me sistemin ICMIC të Gjykatës së Lartë. Situata nuk ka ndryshuar dhe këtu përshkruhen disa nga arsyet pse teknikisht është e pamundur të realizohet shorti elektronikisht. Madje këto vështirësi dhe situata po e ndeshen edhe për problemet që ka vetë Gjykata e Lartë në përpunimin e informacionit dhe administrimin e dosjeve gjyqësore. Mund të informojmë Këshillin edhe se është një sistem teknikisht i vështirë që të ndërhyhet për ta riprogramuar në një mënyrë tjetër dhe po shikohen hapësirat nëse mundet të bëhen disa rregullime. Për këtë është duke punuar aktualisht me KLGj, bashkë me ekspertet e Justice for ALL dhe të Euralius, përfshirë ekspertët e tyre IT. Ashtu siç është i ndërtuar, nëse anëtarët e Këshillit regjistrohen në sistem do të marrin automatikisht dosje dhe do të dalin në publik si gjyqtarë të Gjykatës së Lartë dhe relatorë të dosjeve. Kur të paraqitet raporti i ekspertizës së tyre lidhur me rishikimin e mundshëm a të pjesshëm të sistemit elektronik të menaxhimit atëherë do të shohim nëse ka ndonjë mënyrë për të ndërhyre edhe në lidhje me shortin e KED.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pas diskutimit, orienton anëtarët e Këshillit të shprehin qëndrimin nëse do të procedojnë me hedhjen e shortit sipas rendit të ditës apo do ta ndërpresin mbledhjen për të vijuar njëherë me diskutime të mundshme për ndryshime në aktet nënligjore të Këshillit.

Vitore Tusha shprehu qëndrimin se në fillim të mbledhjes nuk pati kontestim për rendin e ditës dhe kjo është e ezauruar, megjithatë nëse do të ndryshojë kjo mund të vendoset. Natyrshëm aktet nënligjore mund të ndryshojnë por kjo mundësi nuk duhet të bllokojë Këshillin. Situata e vitit të kaluar ka qenë ndryshe sepse nuk ka pasur asnjë akt normativ të miratuar siç kërkohet nga ligji dhe nuk KED nuk mund të fillonte veprimtarinë. Por duhet kujdes sepse neni 7 i ligjit për Gjikatën Kushtetuese përcakton që kryetari i KED thërret mbledhjen brenda 5 ditëve nga publikimi i vakancave dhe duhet të fillojnë procedura e verifikimit. Detyrimi është të zbatohen këto afate dhe ky proces fillon me caktimin e relatorëve. Njëkohësisht mund të punohet për amendamente.

Fiona Papajorigji shprehu qëndrimin se nga diskutimet nuk vërehet ndonjë kontestim për vendimin nr.2/2019 të KED për procedurat e shortit. Në kushtet kur na shpjegohet që nuk mund të bëhet shorti elektronik edhe për ekonomi procedurale duhet të vazhdohet mbledhja me kryerjen e shortit manual.

Saida Dollani shprehu qëndrimin se propozimet për ndryshime të rregullave të tjera nënligjore nuk kanë lidhje me caktimin e relatorit për vendet vakante dhe pa penguar punën për propozime për ndryshime të rregullave, në besim të shpjegimeve se nuk funksionon shorti elektronik, të vazhdohet me procedurat e shortit manual

Ludovik Dodaj shprehu qëndrimin se transparencja është A-ja e çdo institucioni por vlen informacioni i dhënë për mosfunksionimin e shortit elektronik dhe që nuk bëhet pengesë për të hedhur shortin manual për caktimin e relatorëve.

Fatjona Memçaj sparshton se jemi të detyruar të mbajmë qëndrim për çdo çështje por për shkak të papajtueshmërisë dhe heqjes dorë të miratuar nga kryetari e që lidhet me kandidimin e një kandidateje në vendet vakante nuk ka marrë pjesë vitin e kaluar në diskutimin dhe votimin e akteve nënligjore, përveç Rregullores së Brendshme dhe gjendem në të njëjtat kushte edhe tani. Lidhur me hedhjen e shortit shprehu qëndrimin se nuk mund të procedohet me shortin dhe me procedurat e tjera pa u shqyrtuar më parë propozimet për ndryshimin e rregullave nënligjore.

Arjan Qafa shprehu qëndrimin se duhet dhënë kohë e mjaftueshme propozimit dhe shqyrtimit të ndryshimeve në aktet nënligjore dhe pastaj të vijohet me hedhjen e shortit.

Anëtari zëvendësues Bilbil Mete i cili zëvendëson në këtë mbledhje anëtaren Arta Marku shprehu qëndrimin se në rast se propozimet që mund të bëhen me probabilitetin më të madh mund të ndryshojnë ose ndikojnë procedurën e hedhjes së shortit është mirë që këto propozime të diskutohen, të ndryshohen në rast se është e mundur dispozitat përkatëse dhe pastaj të hidhet shorti.

Anëtari zëvendësues Nazmi Troka parashtron mendimin që të ndërpritet mbledhja e sotme, të shqytohen propozimet e znj. Xhaferllari dhe pastaj të procedohet me shortin.

Anëtari zëvendësues Nezir Gjoka parashtron mendimin se mund të shikohen materialet e znj. Xhaferllari dhe të vazhdohet pastaj me shortin.

Këshilli ndërpret menjëherë diskutimet për një pushim të shkurtër, për efekt të domosdoshmërisë së ndërprerjes së procesit të regjistrimit audio, nisur nga mënyra e funksionimit të teknikës së regjistrimit të punimeve të mbledhjes në dispozicion të Këshillit.

PJESA E TRETË E MBLEDHJES

Mbledhja e Këshillit, pas pushimit të shkurtër për shkak të nevojës së sigurimit të procesit të regjistrimit audio të kërkuar nga stafi teknik që mbështet Këshillin, rifillon me disa diskutime të anëtarëve lidhur me çështjen e shtruar për qëndrim dhe vendimmarrje përpara pushimit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani parashtron se anëtarët e Këshillit shprehen qëndrimin lidhur me mënyrën se si do të procedohet. Nëse do të procedohet edhe me shortin manual për vendet vakante duke punuar njëkohësisht për amendime që mund të propozohen në aktet nënligjore të Këshillit apo do të ndërpritet mbledhja për të punuar dhe diskutuar paraprakisht për këto amendime. Nga diskutimi dhe qëndrimet e shprehura dhe që është një lloj vote rezulton që *Ardian Dvorani* shprehu qëndrimin të vazhdohet me realizimin e shortit dhe pastaj në mbledhjen e ardhshme, në varësi dhe të paraqitjes së propozimeve e përgatitjeve që mund të bëhen, të procedohet me diskutime për amendime në aktet nënligjore.

Vitore Tusha shprehu qëndrimin që mund të punohet për rishikime të mundshme në aktet nënligjore por të mos e bllokojmë veprimtarinë dhe që mund të realizohet shorti ditën e sotme, kjo edhe në kushtet kur përbën detyrim në zbatim të nenit 7 të ligjit nr.8577/2000.

Fiona Papajorgji në thelb shprehu të njëjtin qëndrim pra që të realizohet shorti manual duke qenë e qartë se shorti elektronik teknikisht nuk mund të realizohet dhe kur nuk ka kontestime për vendimin nr. 2/2019 të KED për procedurat e shortit. **Znj. Miranda Andoni**, pas diskutimit tjetër të saj pas pushimit të mbledhjes, përfundimisht shprehu qëndrimin se duhet të shqyrtohen më parë mendimet për amendime të mundshme të rregullave në aktet nënligjore dhe të ndërprehet mbledhja pa e hedhur shortin për vendet vakante. **Saida Dollani** shprehu qëndrimin që për sa kohë nuk kanë lidhje me procedurat e shortit, shpjegohet që shorti elektronik nuk mund të funksionojë, atëherë mund të vazhdojë procedura e shortit manual dhe pastaj të punohet edhe me propozime për amendime në aktet e tjera nënligjore.

Ludovik Doda shprehu në thelb qëndrimin se mund të vazhdojë procedura e shortit manual sepse nuk funksionon ai elektronik dhe pastaj të punohet edhe me propozime për amendime. **Nezir Gjoka**, i cili zëvendëson anëtarin Fatjona Memçaj pas shpjegimeve për papajtueshmëri për të njëjtat motive dhe heqjes dorë të pranuar nga kjo lloj vendimmarrje edhe në të kaluarën, shprehu qëndrimin përfundimtar se mund të vijohet me procedurën e shortit. **Arjan Qafa** shprehu qëndrimin që të procedohet me shortin pasi të shqyrtohen kërkesat për amendime në aktet nënligjore. **Bilbil Mete** që në mbledhjen e sotme zëvendëson anëtarin Arta Marku, shprehu qëndrimin që të procedohet me shortin pasi të shqyrtohen kërkesat për amendime në aktet nënligjore. Rezultati i qëndrimeve dhe votimit është 6 (gjashtë) me 3 (tre) që të realizohet shorti manual dhe më pas me punime për amendime në aktet nënligjore për të cilat sigurisht do të duhet që të sillen propozime me shkrim.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, përpara vijimit me procedurat e shortit manual për caktimin e relatorëve, pas konsultimit me anëtarët e Këshillit, shprehet se mbledhja tjetër e Këshillit parashikohet të jetë në datën 27 Janar, ora 15.00. Rendi i ditës do të përcaktohet më saktë pasi të paraqiten propozime me materiale për amendime në aktet nënligjore të Këshillit, të cilat, nëpërmjet kryetarit do të shpërndahen të gjithë anëtarëve dhe pjesëmarrësve në mbledhje, përfshirë kopjen e padisë së ngritur nga Avokati i Popullit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani e deklaroi të mbyllur mbledhjen për çështjet e rendit të ditës për të vijuar menjëherë me procedurat e shortit manual për caktimin e relatorëve për tre vende vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

MBYLLET MBLEDHJA NË ORËN 15.35

SEKRETARE

Ermelinda KADIU

Dorina DULAJ

KRYETAR

Ardian DVORANI